

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	FMN: AI mund të shtojë me 1% produktivitetin evropian, por kërcënon të zgjerojë pabarazitë
ADRESA	https://albeu.com/lajme/bota/fmn-ai-mund-te-shtoje-me-1-produktivitetin-evropian-por-ker-cenon-te-zgjeroje-pabarazite/1018906/
BURIMI	albeu.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	19 shtator 2026, 15:36:51 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	19 shtator 2026, 15:31:13 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	f14c9381ae401556cd07b6a748f223bb868e802ad031a6208f3018c80c236a54
TEKSTI	681044a19440241890e853f074e41111f07c6af5ef05bf2e58280704e2b8c3e6
PAMJA	9fb4f842296de6f12f6873888924164cbb903e75b1118f0c4e3826ffc8c460a7

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	cfc58cf83f98c0cce0f4c5bdab7d40c001f76f1c8f7c1c451ce57b5735d3f2c3
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	c772b20bb2a9907638c08fb1d7825d304059f9fa1ba842ea47b37301891e0c1b
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/cfc58cf83f98c0cce0f4c5bdab7d40c001f76f1c8f7c1c451ce57b5735d3f2c3>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

FMN: AI mund të shtojë me 1% produktivitetin evropian, por kërcënon të zgjerojë pabarazitë



Produktiviteti në Evropë mund të rritet me rreth 1% gjatë pesë viteve të ardhshme falë inteligjencës artificiale. Megjithatë, kjo teknologji mund të zgjerojë njëkohësisht pabarazitë, të rëndojë rrjetet energjetike dhe ta bëjë kontinentin më të varur nga zgjidhjet teknologjike të huaja.

Këto vlerësime janë paraqitur nga Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN) në një dokument të hartuar për takimin joformal të ministrave të Financave të Bashkimit Evropian, i zhvilluar në Dublin më 18 dhe 19 shtator.

FMN-ja parashikon se kostot dhe përfitimet që lidhen me inteligjencën artificiale nuk do të ndahen njësoj ndërmjet shteteve, rajoneve dhe punonjësve. Sipas institucionit, përmbyllja e tregut të vetëm të BE-së do të mundësonte një përhapje më të barabartë të përdorimit të teknologjisë dhe të përfitimeve të saj në të gjithë bllokun me 27 vende.

Rreth 60% e punonjësve në ekonomitë e avancuara evropiane, sipas përlogaritjeve të FMN-së, janë të angazhuar në profesione me ekspozim të lartë ndaj inteligjencës artificiale. Një pjesë e tyre mund ta shtojë produktivitetin përmes mjeteve të AI, ndërsa të tjerë mund të humbasin pozicionet e punës si pasojë e automatizimit të detyrave rutinë.

Dokumenti nënvizon se kërcënimi është më i madh në ato profesione ku inteligjenca artificiale pritet të zëvendësojë kontributin njerëzor, në vend që ta mbështesë apo plotësojë atë.

Ndikimi mbi energjinë përbën një tjetër burim shqetësimi. Aktualisht, qendrat evropiane të të dhënave përdorin rreth 3% të energjisë elektrike të kontinentit, ndërsa zgjerimi i inteligjencës artificiale pritet ta shtojë ndjeshëm kërkesën.

Presioni mbi rrjetet lokale energjetike po ndihet tashmë në qytete me përqendrim të lartë të qendrave të të dhënave. Frankfurti. Londra. Amsterdami. Parisi dhe Dublini renditen ndër zonat më të ekspozuara ndaj këtij

të fundit /



FMN: AI mund të shtojë me 1% produktivitetin evropian, por kërcënon...



Vila luksoze në Palasë që dyshohet se i përket Belinda Ballukut,...



"Kishim konflikte, rrinte te shtëpia e vajzës", zbardhet dëshmia e 6...



Kongresi i Bolivisë miraton kredinë 1.9 miliardë dollarë të...



Nevil Dede vlerëson Partizanin: Emri i madh i rivalit motivon...



Përplasje në Kuvend, Tedi Blushi-Ramës: Halli i shqiptarëve jan...



Elbasani promovon talentin e akademisë një ditë para sfidës n...



ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium

problemi.

Për menaxhimin e situatës, FMN-ja i sugjeron Bashkimit Evropian të shtojë investimet në infrastrukturën ndërkufitare të rrjetit elektrik dhe të forcojë më tej integrimin e tregut evropian të energjisë.

Në dokument ngrihet gjithashtu shqetësimi për një varësi tjetër me rëndësi strategjike. Zhvillimi i modeleve të inteligjencës artificiale dominohet nga SHBA-ja dhe Kina, ndaj Evropa rrezikon të mbështetet gjithnjë e më tepër te teknologjitë e huaja nëse nuk rrit financimet për industrinë e vet të AI.

FMN-ja vëren se edhe brenda Bashkimit Evropian përfitimet e inteligjencës artificiale ka gjasa të jenë të pabarabarta. Ekonomitë më të zhvilluara pritet të marrin pjesën më të madhe të tyre, pasi kanë nivel më të lartë përgatitjeje dhe ekspozimi ndaj kësaj teknologjie.

Shtuar më 19.09.2026 17:31



Volkswagen nis
ristrukturimin më të madh,
Porsche përballet me mbi...



Kongresi i Bolivisë miraton
kreditë 1.9 miliardë dollarë
të FMN-së, heqja e...



Marrëveshja e Trump për
Grenlandën: Çfarë siguron
SHBA-ja nga zgjerimi...



Dronë të paautorizuar
pranë aeroportit të
Luksemburgut, ndërprite...



SHBA jep miratimin
paraprak për paketën
ushtarake prej 2.7 mld...



PISA 2025 ngre alarmin për
arsimin në Europë, Franca,
Gjermania, Holanda dhe...



Hakerët pretendojnë se
depërtuan në sistemet
zgjedhore ruse pak ditë...



Aksidenti tragjik në
Venecia, taksisti hetohet
pas vdekjes së çiftit;...



© 2003 - Albeu Online Media. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kërko...

Kërko

Kryesore

Erion Vellaj
Free Esim
Zgjedhjet 2025
Belinda Balluku
SPAK
Kombëtarja

Kategori

Lifestyle
Showbiz
Tech
Shëndetësi
Argetim
Enciklopedi

Linqet

Live tv shqiptare
Moti në Shqipëri
Travel
Horoskopi
Livescore
News from Albania

Tags

Edi Rama
Albania News
Ilir Meta
Piranjat
gazeta, tv, portale
Sali Berisha

Moti

Moti në Tiranë
Moti në Prishtinë
Moti në Shkup
Moti në Durrës
Moti në Prizren
Moti në Tetovë

© 2003 - Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kontaktimi | Kushtet e Përdorimit | Privacy Policy | Powered by: orihost.com

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.